

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 101	C	Pranverë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Belfjore Qose, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.					
Objektivat		• Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. • Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. • Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjëritimit normativ. • Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). • Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Pikësimi në fjalinë e thjeshtë - Pikësimi i periudhës dhe paragrafëve të gjatë						
2	Ç'është teksti? - Fazat e krijimit të tekstit - Nocioni “tekst” dhe evolucioni i tij - Organizimi i brendshëm i tekstit						
3	- Kriteret dhe parimet e tekstualitetit - Kohezioni dhe koherenca. Elementet e tyre karakterizuese						
4	Rimarrja - Paralelizmi - Parafraza - Proforma						
5	Koha, aspekti, veprimi - Mënyrat e veprimit foljor - Tipologjia dhe klasifikimi i teksteve						
6	Respekti në gjuhë, ose mirësjellja gjuhësore - Respekti në sferën profesionale - Fjalori i rënduar i mediave						
7	Gjuhët kombëtare dhe gjuha zyrtare në Bashkimin Evropian - Anglishtja në kuadrin e BE-së - Cili është koncepti i De Mauros?						
8	Provimi Gjysmë-Final						
9	Institucionet dhe mjetet që përçojnë normat e shqipes standarde - Stilet e shqiptimit - Diksioni						
10	Ushtrime për të shkathtësuar dhe ngulitur drejtshqiptimin - Fjalëshpejtat - Defekti i të folurit shpejt - Frymëmarrja - Zëri						
11	Theksimet - Theksi logjik - Tema/rema						
12	Stilet funksionale të gjuhës shqipe - Fjalët asnjane dhe fjalët me shenjë stilistike - Stilema dhe llojet e ligjëritimit						
13	Teksti dhe domethënie nëntekstore - Mjetet shprehëse gjuhësore të zhanreve të ndryshme						
14	Si të shkruajmë një ese? - Organizimi i paragrafëve dhe i nënçështjeve - Përmbledhje e skicë-idesë						

15	Strategjitë e përkufizimeve - Llojet e përkufizimeve - Termat kyçe dhe termat e papërcaktuar
16	Provimi Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• 1. Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës). • 2. Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002. • 3. Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.
Referenca të tjera	• Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006. • Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmime të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999 • Robert Elsie, Historia e Letërsisë shqiptare. • Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.
2	Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.
3	Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	4	20	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.04
ECTS			5.00